



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:150747
Datë: 28.12.2023
Numri i dokumentit: 05138818

KF.nr.98/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në cilësi të procesmbajtëses në kontestin tregtar administrativ të paditësit D.P.Z “GIPA”, me seli në Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson J.O., avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimin nr.150/2020 të datës 21.07.2020, objekt kontesti vlerësim tatimor, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit së autorizuar të paditësit, avokat J.O., dhe përfaqësueses së autorizuar të paditurës L.XH., me datë 07.12.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit D.P.Z “GIPA”, me seli në Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Jeton Osmani, avokat në Prishtinë.
- II. ANULOHET PJESËRISHT vendimi i të paditurit, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.150/2020 i datës 21.07.2020, dhe atë vetëm në pjesën që i referohet detyrimeve tatimore së bashku me ndëshkimin në shumë prej 6,365.20 €.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësin D.P.Z “GIPA”, me seli në Podujevë, ta liroj nga detyrimet tatimore së bashku me ndëshkimin në shumë prej 6,365.20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.
- IV. MBETËT NË FUQI vendimi i të paditurit, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.150/2020 i datës 21.07.2020 dhe VLERËSIMET tjera tatimore dhe ndëshkimet jo kontestuese në shumën prej 221.49 euro për periudhën kontestuese, mbesin në fuqi sipas raportit të Kontrollit të datës 14.02.2020, të Administratës Tatimore të Kosovës, të vërtetuar me vendimin kontestues nr.150/2020 të datës 21.07.2020, dhe njoftim vlerësimeve nga e paditura.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datën 04.11.2020, ka iniciuar Kontestin Tregtar administrativ kundër vendimit nr.150/2020 të datës 21.07.2020 të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor - kryesor përfaqësuesi i autorizuar palës paditëse deklaroi se: Mbesim pranë deklarimeve të deri tanishme, plotësimin e dytë të ekspertizës e kemi pranuar dhe për të njëjtën nuk kemi vërejtje. Meqenëse nga eksperti është konstatuar se kemi pasur mbivlerësim të tatimeve e që për rrjedhojë kam pasur edhe ndëshkime në seancë e bëjmë precizimin e kërkesëpadisë ashtu që kërkoj nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, të anulohet pjesërisht vendimi kontestues dhe të obligohet e paditura që këtu paditësin ta lirojë nga detyrimet tatimore së bashku me ndëshkimin në shumë prej 6.365.20 euro, ndërsa të mbetet në fuqi vendimi kontestues në pjesën tani me jo kontestuese referuar tatimeve dhe ndëshkimeve për periudhën kontestuese në shume prej 221.49 euro. Kurse në fjalën përfundimtare thekson se mbesim në tërësi pranë deklarimeve të tanishme, duke konsideruar se nga provat e administruara si dhe nga ekspertiza financiare është konstatuar baza e kërkesëpadisë dhe është vërtetuar fakti se paditësi pa të drejtë është ngarkuar me tatime dhe ndëshkime si në raportin e kontrollit dhe në vendimin e kontestuar, për çka gjykatës i propozojmë që ta aprovojë sipas precizimit të kërkesëpadisë bërë në këtë seancë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 13.07.2021 i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale, duke theksuar se ATK-ja në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, shqyrtimit të provave ka konstatuar se padia e paditësit "GIPA" është e pa bazuar ndërsa tatimi shtesë është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në ligj. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor - kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur deklaroi se: Mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve në procese gjyqësore, plotësimin e ekspertizës financiare e kemi pranuar, të cilën plotësim të ekspertizës sikurse edhe atë paraprake i kundërshtojmë sepse pavarësisht që eksperti e verifikon sipas detyrës së gjykatës deponimin e caktuar për vitin 2018 prapë se prapë për çështjet tatimore nuk e kryejnë ekspertizën ashtu siç duhet. E kundërshtojmë precizimin e përfaqësuesit të palës paditëse, për faktin se ajo çka është dal në raportin e kontrollit është e saktë dhe e drejtë duke u bazuar në gjendjen faktike porositë nga blloku i shënimeve të gjetura tek biznesi dhe deponimet bankare.

Kërkojmë nga gjykata që të refuzojë në tërësi padinë dhe precizimin e kërkesëpadisë si të pa drejtë dhe të pa bazuar, ekspertizës financiare dhe dy plotësimeve të saj të mos i'a falë besimin për shkak se eksperti nuk e ka konstatuar saktë gjendjen faktike edhe pas dy plotësimeve të saj, duke kalkular deponimet e djalit të paditësit e që në rastin konkret nuk ka të bëjë fare për çështje tatimore, dhe të vërtetojë si të drejtë të bazuar me ligj dhe fakte vendimin e departamentit të ankesave nr.150/2020 të dt.21.07.2020. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimin nr.150/2020 të dt. 21.07.2020, përgjigjen në padi të dt.13.07.2021, pasqyrën e llogarisë në TEB për periudhën 01.09.2019 - 13.02.2020, 2014 - 2019 , 01.01.2018 - 31.12.2018, ankesën e ushtruar në ATK, raportin e kontrollit të dt.14.02.2020, vendimin 0041/2020 të dt.16.02.2020, tabelën me të dhëna për deponime dhe tërheqje për periudhën 31.12.2013 deri 05.10.2019, gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve të tjera së bashku me gjendjen e borxheve të dt.12.07.2023, pasqyrën nga institucioni capital nr.2243/2023, 491/2023, 535/2023, deklaratën e bashkësisë familjare F114613815, deklaratën nën betim të A.H., G.H., ekspertizën financiare të dt.30.03.2023, plotësim ekspertizën financiare të dt.18.10.2023 dhe plotësimin e dyte të ekspertizës financiare të dt.17.11.2023.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, Raportit të kontrollit të dt.14.02.2020, deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti subjektiv D.P.Z "GIPA", nga e paditura ATK i është nënshtruar kontrollit ku objekt i kontrollit kanë qenë këstet tremujore për biznese të vogla (IS) – TM1/2014-TM3/2019, Kontributet pensionale për pronarin (CI) TM1/2014-TM3/2019, Tatimi i mbajtur në burim për paga (ËM)-01/2014-09/2019, Kontributet pensionale (CM) periudha 01/2014-09/2019 dhe tatimi në qira (ËR) periudha 09/2015-09/2019, e ku nga ky kontroll kanë rezultuar ndryshime

dhe atë nën deklaram, tatim shtesë dhe kontribut pensional shtesë. Tutje, nuk është kontestuese as fakti se subjekti në procedurë ka ushtruar ankesë pranë Departamenti të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila me datën 21.07.2020 ka marrë vendimin nr.150/2020, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e këtu paditësit, dhe njoftim rivlerësimet pas kontrollit i ka vërtetuar si të bazuara, e kundër të cilit paditësi me padinë e datës 04.11.2020, ka iniciuar këtë kontest tregtar - administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave në shkallë të dytë e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e këtu paditësit, dhe njoftim rivlerësimet pas kontrollit i ka vërtetuar si të bazuara, me arsyetim se Divizioni i Ankesave pas analizimit të dosjes në dispozicion, gjegjësisht Raportit të Kontrollit vërteton se tatimpaguesi nuk ka pasur deklarime për periudhat kontrolluese derisa bazuar në transaksionet bankare ka pasur deponime të vazhdueshme për të cilat nuk ka arritur të argumentojë burimin e mjeteve, e po ashtu bazuar në shënimet e gjetura ka kryer shërbime (të dhëna për emrat e porosive, vlerat e shitjes si dhe numrat e kontakteve). Duke mos deklaruar në kundërshtim me nenin 4 dhe 5 të Ligjit Nr.05/L-028 për Tatim në të Ardhura Individuale. Tutje ka theksuar se sa i përket pretendimit të tatimpaguesit se këto deponime kanë burime nga mjetet e dërguara nga vendet e jashtme, gjegjësisht nga vëllai për ndërtimin e shtëpisë duke i'a bashkangjitur edhe ankesës me shkrim disa nga këto pagesa të pranuar përmes RIA (Euronet Payment Service), Divizioni i Ankesave pas analizimit të provave të sjella të tatim paguesit si dhe dëshmime në bazë të të cilave ka vlerësuar kontrollin, konstaton se pretendimi i tatim paguesit vërtetohet si i pabazuar. Këtë konstatim Divizioni i Ankesave e ka mbështetur bazuar në deponimet e bëra në llogarinë bankare TEB ku shihet se vlerat e deponuara janë shumë më të larta sesa dërgesat e pranuar nga jashtë, e po ashtu nuk ka as përputhje kohore mes dërgesave dhe deponimeve.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.98/22 të datës 19.01.2023, ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar XH.K. me detyra përkatëse.

Eksperti financiar me datë 30.03.2023, ka paraqitur në Gjykatë ekspertizën financiare e cila ekspertizë është plotësuar me datën 18.10.2023 dhe me datën 17.11.2023. Në plotësimin e ekspertizës të datës 17.11.2023 eksperti financiar ka konstatuar se sipas të dhënave të cekura rezulton se në TM3-2016, tatimpaguesi ka deponuar 850.00 euro ndërsa ka pranuar nga institucioni financiar Capital në shumë prej 1,050.00 euro apo 200.00 euro më shumë. Sipas kësaj gjendje vërtetohet se tatimpaguesi ka mbulesë për deponimet e bëra. Tutje ka theksuar se në TM1-2018 tatimpaguesi ka deponuar mjete në bankë në shumë prej 10,250.00 euro, ndërsa ka pranuar nga institucioni financiar Capital shumën prej 3,150.00 euro apo për 7,100.00 euro më pak. Me ekzaminimin e inkasimeve nga jashtë nga institucioni financiar Capital për vitin 2017 që i paraprin vitit 2018 rezulton se inkasimet në vitin 2017 kanë qenë në shumë prej 6,600.00 euro apo në total me inkasimet në vitin 2018 janë në shumë prej 9,750.00 euro, apo më pak për shumën 500.00 euro. Sipas kësaj gjendje rezulton se tatimpaguesi ka pasur pranim të mjeteve të cilat i ka deponuar në periudhat e mëvonshme në diferencën prej 500.00 euro, rezulton tatimi shtesë në të ardhura prej 45.00 euro dhe kontributi pensional shtesë prej 2.28 euro. Tutje ka theksuar se në TM2-2019 tatimpaguesi nuk ka deponuar mjete, por ka deponuar mjete nga institucioni financiar Capital në shumë prej 1,300.00 euro apo 1,300.00 euro më tepër. Sipas kësaj gjendje rezulton se tatimpaguesi nuk ka obligime tatimore në këtë periudhë. Kurse në TM3-2019 tatimpaguesi ka deponuar mjete në shumë prej 3,300.00 euro dhe ka pranuar nga institucioni financiar Capital shumën prej 1,900.00 euro apo 1,400.00 euro më pak. Pra sipas kësaj gjendje rezulton se tatimpaguesi nuk ka obligime tatimore në këtë periudhë sepse mungesa e mjeteve në këtë periudhë mbulohet nga teprica e mjeteve paraprake.

Gjykata e ka pranuar plotësim ekspertizën financiare të datës 17.11.2023 të ekspertit XH.K., në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Eksperti financiar në seancën e shqyrtimit gjyqësor – kryesor të datës 07.12.2023 ka deklaruar se: Sipas detyrës së marrë nga seanca e fundit kam siguruar pasqyrën e transaksioneve bankare për vitin 2018 dhe mbi bazën e këtyre të dhënave kam vërtetuar se ka pasur deponime në vitin 2018 në shumë prej 10.250.00 euro dhe në krahasim me mjetet e pranuar nga jashtë deri në këtë periudhë janë në shumën prej 9.750.00 euro, pra që kemi një ndryshim prej -500 euro me pak mjete të pranuar sesa të deponuara, dhe kam bërë kalkulimin për diferencën ku ka rezultuar se tatimi shtesë për të ardhura është 45 euro dhe kontributi personal 2.28 euro. Nga ekspertiza financiare dhe plotësimet e saj del gjendja se këtu paditësi mbetet obligues i detyrimeve tatimore

dhe atë 143.28 euro për tatimin në të ardhura dhe tatimin në paga, tatimin në qira, dhe kontributi pensional, ndërsa ndëshkimi për këto obligime është në shumë prej 78.21 euro e që të gjitha kapin shumën prej 221.49 euro, ndërsa sipas ATK-së ngarkesa tatimore për të gjithat llojet e obligimeve tatimore dhe ndëshkimeve ka qenë në shumë prej 6.586.69 euro , ndërsa pas korigjimit si më lartë rezulton se kanë qenë tatime të mbivlerësuara dhe atë në shumë prej 6.365.20 euro.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është plotësisht i bazuar dhe i drejtë dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore, për t'ia njohur vlerësimet tatimore për periudhën përkatëse në shumën prej 6,365.20 €. Prandaj, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 81, par 2, nën par. 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 46 par.5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit dhe e anuloi pjesërisht vendimin e kontestuar, duke e obliguar të paditurën që paditësin ta liroj nga detyrimet tatimore së bashku me ndëshkimin në shumë prej 6,365.20 €, kreyt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor, ndërsa vlerësimet tjera tatimore dhe ndëshkimet jo kontestuese në shumën prej 221.49 euro për periudhën kontestuese, i ka lënë në fuqi sipas raportit të Kontrollit të datës 14.02.2020, të Administratës Tatimore të Kosovës, të vërtetuar me vendimin kontestues nr.150/2020 të datës 21.07.2020, dhe njoftim vlerësimeve nga e paditura.

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. *“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”*, paragrafi 2. *“Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”*. Paragrafi 3. *“Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”*, paragrafi 4. *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*, dhe paragrafi 5. *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendos edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”*.

Lidhur me njohjen e detyrimeve tatimore së bashku me ndëshkimin në shumën prej 6,365.20 €, Gjykata është bazuar në plotësim ekspertizën financiare të ekspertit financiar XH.K., të datës 17.11.2023.

Vlerësimet tjera tatimore dhe ndëshkimet tani më jo kontestuese dhe atë në shumën prej 221.49 euro për periudhën kontestuese, mbesin në fuqi sipas raportit të Kontrollit të datës 14.02.2020 të Administratës Tatimore të Kosovës, e të cilat janë vërtetuar me vendimin kontestues nr.150/2020 të datës 21.07.2020, dhe njoftim vlerësimeve nga e paditura, ngase për të njëjtat këtu paditësi në seancën shqyrtimit gjyqësor kryesor të datës 07.12.2023, ka propozuar që *“të mbetet në fuqi vendimi kontestues në pjesën tani më jo kontestuese referuar tatimeve dhe ndëshkimeve për periudhën kontestuese në shume prej 221.49 euro”*. Pra, në rastin konkret paditësi të njëjtat i ka bërë si jo kontestuese dhe se për të njëjtat ka pranuar edhe të gjeturat nga plotësim financiare e datës 17.11.2023, andaj edhe gjykata nuk është lëshuar më tej në elaborim dhe vlerësim të të njëjtave.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.98/2023, datë 07.12.2023

Zyrtare Ligjore

Amire JAHIRI

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.